

KONTRATË KONCESIONI

PER BURIMIN UJOR "SASAJ, BUNEC", NË KOMUNËN LUKOV, SARANDË

Tiranë



MINISTRIA E MJEDISIT

DHE,

SHOQËRIA "BLUE EYE ONE" SH.P.K



PËRMBAJTJA

| Nr. | Nenet | Faqja |
|---|---|-------|
| Dispozita të përgjithshme. | | |
| 1. | Përkufizime..... | 6 |
| 2. | Interpretime..... | 8 |
| 3. | Objekti i Koncesionit..... | 9 |
| 4. | Kërkime dhe studime | 10 |
| Dhënja dhe dorëzimi i koncesionit. | | |
| 5. | Dhënja e koncesionit | 10 |
| 6. | Kushtet hidrologjike dhe hidroteknike | 11 |
| 7. | Periodha e koncesionit..... | 12 |
| 8. | Data Efektive e Kontratës | 12 |
| 9. | Mekanizmat e Rinovimit..... | 12 |
| 10. | Ekskluziviteti | 13 |
| 11. | Autorizime , leje dhe licenca | 13 |
| 12. | Dorëzimi i mjediseve të Koncesionit dhe lehtësirave | 14 |
| 13. | Procedura e dorëzimit | 14 |
| Masat Financiare | | |
| 14. | Shpërblimi i koncesionerit | 15 |
| 15. | Tarifa e Koncesionit | 15 |
| 16. | Modalitetet e pagesës..... | 15 |
| 17. | Kostot dhe shpenzimet e rishikimit | 16 |
| 18. | Financimi i koncesionit..... | 16 |
| 19. | Vlera e riinvestimit | 17 |
| 20. | Kontrollet financiare | 17 |
| 21. | Sanksionet për vonesat në fillimin e punimeve | 18 |
| 22. | Përfundimi i punimeve | 18 |
| Të drejtat dhe detyrimet e palëve | | |
| 23. | Detyrime të autoritetit kontraktues | 19 |
| 24. | Plani I projektit..... | 19 |
| 25. | Programi i punimeve | 19 |



| | |
|---|----|
| 26. Testimi..... | 20 |
| 27. Vonesat në zbatim | 21 |
| 28. Zgjidhja e pasojave të vonesës | 21 |
| 29. Vonesat në arritjen e Planit të Projektit për shkak të Autoritetit..... | 22 |
| 30. Monitorimi dhe mbikqyrja | 23 |
| 31. Shërbimet | 24 |
| 32. Pasojat e Shkakut të Autoritetit në fazën Operacionale..... | 24 |
| 33. Neni 33..... | 25 |
| 34. Neni 34..... | 25 |
| 35. Përmirësimi I Shërbimeve | 25 |
| 36. Neni 36..... | 25 |
| 37. Rishikimi i shërbimeve | 26 |
| 38. Regjistra dhe raporte..... | 26 |
| 39. Kontrolli i ndryshimit | 26 |
| 40. Personeli | 27 |
| 41. Të drejtat e koncesionerit | 27 |
| 42. Detyrime të përgjithshme të koncesionerit | 28 |
| 43. Detyrime të posacme të koncesionerit | 28 |
| 44. Forca Madhore..... | 29 |
| 45. Pasojat e Ngjarjeve të Forcës Madhore..... | 29 |
| 46. Neni 46..... | 29 |
| 47. Dëmshpërblimi..... | 30 |
| 48. Konfidencialiteti | 31 |
| 49. Kufizimet në përgjegjësi | 31 |
| 50. Kufijtë financiarë | 32 |
| 51. Sigurimi | 32 |
| 52. Garancitë e Autoritetit | 32 |
| 53. Garancitë e Koncesionerit | 33 |
| 54. Sigurim I kontratës | 33 |
| 55. Formula e Sigurimit të kontratës | 34 |
| 56. Nën – kontraktimi | 34 |
| 57. Transferimi I Kontratës | 34 |

Përfundimi i kontratës

| | |
|---|----|
| 58. Mbarimi i kontratës | 35 |
| 59. Zgjidhja e Kontratës nga Autoriteti | 35 |
| 60. Zgjidhja e Kontratës nga Konçisioneri | 35 |
| 61. Zgjidhja e Kontratës nga të dyja palët | 36 |
| 62. Njoftimi i përfundimit | 36 |
| 63. Procedura e zgjidhjes së mosmarrveshjes | 36 |
| 64. Procesi i shkallëzimit | 37 |
| 65. Procedura e shkallëzimit..... | 37 |
| 66. Pasoja e përfundimit | 38 |

Dispozitat përfundimtare.

| | |
|---|----|
| 67. Marrveshja e palëve..... | 39 |
| 68. Ndarja | 39 |
| 69. Sigurime të mëtejshme | 39 |
| 70. Kontrata si një e tërë | 40 |
| 71. Të drejtat e palëve të treta | 40 |
| 72. Njoftimet | 40 |
| 73. Rregullimi | 41 |
| 74. Ligji rregullues dhe juridiksioni | 41 |
| 75. Kopjet e hartuara | 42 |
| 76. Hyrja në fuqi | 42 |

ANEKSET

| | |
|--|----|
| Aneksi 1, Procedura e ndryshimeve të kontratës | 42 |
| Aneksi 2, Plani i Projektit | 44 |
| Aneksi 3, Plani i Biznesit | 45 |
| Aneksi 4, Plani i Riinvestimit | 46 |
| Aneksi 5, Certifikatë Garancie Kontrate | 47 |

KJO KONTRATË, lidhet sot më 06.08.2014

NDËRMJET:

Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave të Republikës së Shqipërisë (në vazhdim referuar si "**Autoriteti**") e përcaktuar si e tillë me **Vendim I Këshillit të Ministrave**, Nr.272, datë 3 prill 2013, "*Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënje me koncesion të burimit ujqor 'Sasaj', dhe miratimin e bonusit , në procedurën përzgjedëse konkurruese , që I jepet shoqërisë 'Blue Eye One' "* , përfaqësuar nga Znj Sofia Merkaj, sipas Autorizimit Nr....., datë....., të lëshuar nga Titullari I Autoritetit.

DHE

Shoqërisë 'Blue Eye One' sh.p.k (në vazhdim referuar si '**Konçisioneri**'), e regjistruar si

Autoriteti është I autorizuar të nënshkruajë këtë Kontratë:

NDËRSA :

- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar përmes Vendimit Nr 12.datë 23.07.2012, " Për përcaktimin e Autoriteti Kontraktues për dhënje me koncesion të burimit ujqor 'Sasaj' dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë", dhe ka përcaktuar Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, si Autoriteti.
- Autoriteti ka shpallur, Dokumentet Standarte të Procedurës Përzgjedhëse Konkurruese për Dhënien me koncesion të përdorimit të ujit të burimit 'Sasaj'.
- Konçisioneri ka paraqitur një propozim në përgjigje të procedurës konkurruese në lidhje me "Dhënien me koncesion të përdorimit të ujit të burimit 'Sasaj' ", propozim i cili është pranuar nga Autoriteti.

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

Autoriteti i ka dërguar Koncesionerit më 12.10.2012, nëpërmjet Dokumentit Nr 4 date 12.10.2012, 'Njoftimin e Fituesit', duke pranuar propozimin e paraqitur nga ky i fundit.

Autoriteti dhe Koncesioneri përfshihen në këtë kontratë me qëllim për të vënë në zbatim koncesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuar më poshtë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

- 1.1 'Kontrata e Koncesionit' nënkupton marrveshjen e nënshruar midis Koncesionerit dhe Autoritetit Kontraktues, si dhe anekset që do të bashkëlidhen me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
- 1.2 'Koncesioneri' ose 'Shoqëria koncesionere' nënkupton shoqërinë: **Blue Eye One**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e rregjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit me numër unik identifikimi (NUIS): L 11312027 P.
- 1.3 'Personel I koncesionerit' nënkupton të gjithë punonjësit, agjentët, këshilltarët dhe kontraktorët e Koncesionerit dhe /ose të cdonjerit nga nën-kontraktorët.
- 1.4 'Autoriteti' nënkupton Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave të Republikës së Shqipërisë.
- 1.5 'Data Efektive' nënkupton nenshkrimi nga palet para Noterit Publik
- 1.6 'Viti financiar I kontratës' nënkupton një periudhë prej 12 muajsh që fillon në Datën Efektive ose në përvjetorin e Datës Efektive. ' Viti financiar' nënkupton një periudhë që fillon cdo vit më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetorin në vijim.
- 1.7 'Koha e vënies në shfrytëzim e linjës' nënkupton periudhën nga data që ofertuesi fitues, sipas kërkesave të legjislacionit, do të pajiset me lejen/lejet, autorizimin/autorizimet e nevojshme për nisjen e kryerjes së punimeve të ndërtimit, deri në momentin e realizimit të projektit dhe përgatitjen e ofertuesit për tu pajisur me lejen, autorizimin, miratimin (dokumentin përkatës) lëshuar nga institucioni kompetent për vënien në shfrytëzim të tij.
- 1.8 'Dokumentimi' nënkupton përshtkrimet e *Shërbimeve* dhe *Niveleve të Shërbimeve*, përcaktime të hollësishme teknike, manual përdorimi, manual operimi, përkufizime dhe procedura të proceseve, dhe cdo document tjetër I tillë sic: a) është kërkuar të paraqitet nga Koncesioneri për Autoritetin bazuar në këtë Kontratë; b) është kërkuar nga Koncesioneri

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

me qëllim që të sigurojë Shërbimet; c) ka qënë ose do të krijohet me qëllim sigurimin e Shërbimeve.

- 1.9 'Informacioni Konfidencial' nënkupton çfarëdo informacioni, sido që të përcohet, që ka lidhje me çështje biznesi, pune, zhvillime, sekrete tregtare, njohuri, personelin dhe furnitorë të secilës Palë si dhe cdo informacion tjetër që është bërë e qartë që është konfidencial (pavarësisht nëse atij I është vendosur shenja "konfidencial") ose që do të konsiderohej pa dyshim si konfidencial.
- 1.10 'Praktikat e Industrisë së Mirë' nënkupton ushtrimin deri në atë shkallë aftësish , kujdesi, përkujdesje, efektiviteti dhe kornizat kohore sikurse do të pritet nga një shoqëri drejtuese brenda industrisë përkatëse ose sektorit të biznesit.
- 1.11 'Faza Operacionale' nënkupton faza në të cilën Koncesioneri do të dorëzoj *Shërbimet Operacionale* , e indentifikuar si e tillë në Planin e Projektit.
- 1.12 'Sigurimi I Kontratës' nënkupton garancinë që duhet të jepet nga Koncesioneri në përputhje me nenin 54 të kësaj Kontrate.
- 1.13 'Kontrolli' nënkupton drejtimin e drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të marrdhënjeve të dikujt tjetër me anë pronësie, kontrate ose cdo mënyre tjetër.
- 1.14 'Procedurën e Kontrollit të Ndryshimit' nënkupton procedurën për të ndryshuar këtë Kontratë, sikurse është përcaktuar në Aneksin 1.
- 1.15 'Ngjarja' është cdo shkak që prek përmbushjen nga ana e njëres Palë të detyrimeve të saj që rrjedhin nga aktet, ngjarjet, përjashtimet, ndodhitë apo mosndodhitë përtej kontrollit të arsyeshëm të saj, duke përfshirë pa kufizim aktet e pashpjegueshme, trazirat, luftën apo konfliktet e armatorura, aktet e terrorizmit, zjarret, përmytjet, stuhitë ose tërmetet apo fatkeqësitë, por duke përfshirë cdo konflikt me natyrë industriale në lidhje me Koncesionerin, Personelin e Koncesionerit apo çfarëdo personeli tjetër në zinxhirin e furnizimit të Koncesionerit apo Nën-kontraktorit.
- 1.16 'Pazotësia' nënkupton cdo shkelje të detyrimeve të Palës përkatëse ose cdo pazotësi tjetër, akt, mungesë, neglizhencë ose qëndrim të Palës përkatëse, punonjësve të saj, nëpunësve, agentëve, ose nën-kontraktorëve në lidhje me subjektin e kësaj Kontrateje dhe përsa i përket përgjegjësisë të secilës nga këto Palë në lidhje me tjetrën.
- 1.17 'Ligji I zbatueshëm' nënkupton cdo ligj të brendshëm apo legjislacion dytësor (dekrete, vendime, urdhra apo udhëzime në nivel qëndror apo vendor) të zbatueshëm në fuqi gjatë periudhës së Koncesionit. Ligji I zbatueshëm përfshin, por pa u kufizuar në to, këto akte :
Ligjin Nr.9963, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi koncesionet"
- Ligjin Nr.8934, datë 5 shtator 2002, "Për Mbrojtjen e mjedisit"

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

- Ligjin Nr.8093, datë 21 mars 1996, "Për rezervat ujore"
 - Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.27, datë 19 janar 2007, "Mbi miratimin e kritereve të vlerësimit në lidhje me dhënjen e koncesioneve"
 - Vendim I Këshillit të Ministrave, Nr 272, datë 3 prill 2013, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien për përdorim me koncesion të burimit ujqor 'Sasaj' dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që I jepet shoqërisë 'Blue Eye One' "
 - Vendim I Këshillit Kombëtar të Ujqit Nr.12, datë 23 shtator 2012, "Për miratim në parim të kërkesës , për përdorim me koncesion, të formës BOT, të burimit ujqor, 'Bunec', komuna Lukovë "Për imbotilim të ujqit të pijshëm, për transportim dhe eksportim të ujqit", subjektit 'Blue Eye One shpk"
 - Vendim I Këshillit Kombëtar të Ujqit, Nr. 4, datë 12 tetor 2012, "Për miratimin në parim të dhënjes me koncesion të burimit ujqor 'Sasaj', Bunec , Sarandë".
 - Udhëzim Nr.1, datë 7 janar 2008, "Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar Leje Mjedisore".
- 1.18 'Aneks' nënkupton një shtojcë ndaj kësaj Kontrate Koncesioni që formon një pjesë integrale të saj.

Neni 2

Interpretime

Në këtë Kontratë, përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe :

- 2.1 Njejësi përfshin shumësin dhe anasjelltas. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër.
- 2.2 Referimi tek një akt ligjor, dispozitë statutore apo instrument statutor përfshin referim tek ai akt ligjor, dispozitë statutore apo instrument statutor sic është ndryshuar, shtuar apo rimiratuar kohë pas kohe si dhe tek cdo rregullore e nxjerrë në bazë e për zbatim të tij. Pasoja e cfarëdo ndryshimi, shtese apo rimiratimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me nenin 39 të kësaj Kontrate.
- 2.3 Një referim tek secili organ është nëse ai organ: a) zëvendësohet nga një organizëm tjetër, vlerësohet se I referohet asaj organizate dhe b) pushon së ekzistuari, vlerësohet se I referon organizatës që më afër ose në shkallën më të madhe shërben për të njejtat qëllime ose objekte sikurse ai organ.

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

- 2.4 Titujt dhe renditja numerike e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.

Neni 3

Objekti I koncesionit

- 3.1 Me anën e kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave, jep me Koncesion përdorimin e ujit të burimit 'Sasaj' dhe përcakton tërësinë e të drejtave e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionerit, si dhe përcakton tërësinë e shërbimeve, detyrimeve që lidhen me ekzekutimin, mbikqyrjen dhe administrimin e Kontratës së Koncesionit. Forma e Kontrates së Koncesionit është shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit (BOT).
- 3.2 Kontrata e Koncesionit përbëhet nga kjo Kontratë dhe Aneksat e saj. Janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, si anekse të saj, Dokumentet standarte të procedurës konkurruese (dokumentet e tenderit) dhe oferta e koncesionarit. Në rast mospërputhje midis dokumenteve të ndryshme të kësaj Kontrate, mospërputhjet do të zgjidhen sipas kësaj rradhe prioriteti, duke filluar nga më mbizotëruesja e cila është kjo Kontrate Koncesionare:
- 3.3 Vendndodhja e objektit të kontratës është pranë fshatit Bunec, komuna Lukovë, Sarandë. Burimi 'Sasaj' ndodhet në zonën Shkallnevic, zonë bregdetare jugperëndimore e Shqipërisë me plansheta 1: 25000 me nomeklaturë.

K- 34 136 D-d

X= 4 431 146,44

Y= 4 406 531,00

Z= 42m

Neni 4

Kërkime dhe Studime

*One
mia*

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

- 4.1 Koncesionari pranon që ka bërë dhe do të bëjë kërkimet dhe studimet e tij për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Kontratë, duke përfshirë kërkimin e këtij informacioni nga Autoriteti Kontraktues, informacion i cili sipas Koncesionari kërkohet për një qëllim të tillë.
- 4.2 Koncesionari pranon se është në dijeni të plotë për sa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit.
- 4.3 Koncesionari ka të gjithë informacionin, të drejtat, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar me qëllim që t'i japë mundësi atij të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë, duke përfshirë mundësinë për të përmbushur dhe realizuar Projektin Koncesionar.
- 4.4 Autoriteti garanton se të gjitha të dhënat e tij të vëna në dispozicion të Koncesionarit duke përfshirë edhe Dokumentat Standarte të Procedurës Përzgjedhëse Konkurese janë të sakta, të vërteta dhe pa gabime.

DHËNJA DHE DORËZIMI I KONCESIONIT

Neni 5

Dhënja e koncesionit

- 5.1 Konform kushteve dhe afateve të parashikuar në këtë Kontratë dhe në Anekset bashkëlidhur, Autoriteti jep dhe autorizon Koncesionerin të zbatojë projektin në lidhje me përdorimin e ujit të burimit 'Sasaj' (Bunec), komuna Lukovë, Sarandë, nëpërmjet Financimit, Projektimit, Ndërtimit, Venien në Punë, Administrimin, Mirëmbajtjen e Veprës si dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesioneri tek Autoriteti Kontraktues.
- 5.2 Sheshi, e Drejta për Kalim, Gezimi i Qete do të konsiderohen se i jepen koncesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të certifikatave siguroese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të kënashme për Autoritetin Kontraktues), se Koncesionari është pajisur me policat e sigurimit dhe garancite e kërkuara për këtë qëllim. Në lidhje me dhenien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gezimit të Qete dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin e Burimit, Koncesionari e pranon sheshin siç është dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim. Në

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

rast se per dhenien e sheshit do te konsiderohet i nevojshem shpronesimi i truallit qe eshte prone private, atehere Koncesionari do ti paraqese Autoritetit Kontraktues te gjitha dokumentet dhe informacionet e nevojshme duke perfshire edhe identifikimin e sakte te parcelave qe do te shpronesohen. Autoriteti Kontraktues do te miratoje propozimet per shpronesim dhe do te ndjeke procedurat e shpronesimit sipas dispozitave ligjore perkatese, me kusht qe te gjitha kostot dhe shpenzimet qe lidhen me sa me siper te perballen nga Koncesionari, ne rast te kundert Koncesionari ka te drejten e demshperblimit per te gjitha demet ose shpenzimet e tjera qe lidhen me mospermbushjet e Autoritetit Kontraktor.

5.3 Në vijim, për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate, Koncesioneri do të sigurojë përgatitjen, përcaktimin, zhvillimin, zbatimin dhe operimin e proceseve të mëposhtme :

- Aktiviteti do të konsistojë në punime (kaptazh, linjë dërgimi në drejtim të molit, rrugëve lidhëse me rrugën nacionale, fabrikë imbotilimi).
- Transporti i ujit për tregun vendas dhe atë të huaj do të bëhet me transport detar dhe tokësor.
- Lënda e parë (uji) që merret nga kaptazhi nëpërmjet linjës së dërgimit me diametër 400 mm, kalon në matësin e sasisë të ujit dhe futet në rezervuarin e pritjes së ujit.
- Reparti i furnizimit dhe trajtimit të ujit ka qëllim të depozitojë sasinë e ujit në disa rezervuarë, për të siguruar vazhdueshmërinë e procesit dhe vijueshmërinë sasiore konstante në raport me kohën.
- Linja e formimit dhe mbushjes së shisheve ka për funksion ta prodhojë shishen brenda standartit.

3.1 Krahas linjës së mësipërme fabrika do të pajiset me:

- Laborator për kryerjen e analizave të ujit
- Impiant zjarrfikës
- Magazine për lëndën e parë
- Magazinë për produktin përfundimtar
- Automjete transporti
- Kabinë elektrike dhe gjenerator.

Neni 6

Kushtet hidrologjike dhe hidroteknike

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

6.1 Në zbatim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, Nr.4, datë 12 tetor 2012 "Për miratimin në parim të dhënjes me koncesion të burimit ujqor 'Sasaj', Bunec, Sarandë" është vendosur që sasia e ujit që do të jepet për përdorim të jetë : - **50 l/sek për periudhën 15 Qershor- 30 Tetor**

6.2 - **200 l/sek për periudhën 1 Nëntor -15 Qershor**

6.3 Kaptazhi te zgjidhet me ane te nje pusete me kaperderdhes ku te realizohet ndarja e prurjes se burimit sipas sasise dhe periudhave te percaktuara me siper. Ne veperen e kaptazhit ndarja e ujit duhet te jete automatike, me ane te kaperderdhjes pa instaluar porta apo saracineska komandimi.

6.4 Te mos ndalohet dhe devijohet rrjedhja nga shtrati natyral i perroit, sa i takon pjeses tjeter te prurjes se burimit te mbetur nga sasia e percaktuar me siper.

6.5 Ne perputhje me nenin 39 te ligjin Nr. 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujqore", te lejohet rrjedhja ekologjike e llogaritur sipas ketij neni. Për të realizuar kapjen e sasisë ujqore të përcaktuar, për mbrojtjen nga ndotjet e mundshme ëshë parashikuar ndërtimi I një kaptazhi me dy mjedise vendgrumbullimi të ujit dhe dhoma e manovrimit.

Nga kaptazhi do të dalë linja e dërgimit për në fabrikën e imbotilimit dhe në molin e ngarkimit të anijeve, qe do të jete rreth 1300m.

Neni 7

Periudha e Koncesionit

Kocesioni jepet për një periudhë prej 20 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj (Data Efektive) dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 20-të të Datës Efektive (Periudha Efektive). Megjithatë, në rastin e një Zgjidhjeje përpara afatit 20 vjecar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

Neni 8

Data Efektive e Kontratës

Data efektive e kësaj kontrate do të jetë data në të cilën do të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme : a) nënshkrimi i kësaj Kontrate rregullisht nga të dyja palët; dhe b) vertetimi i nënshkrimit te paleve nga Noteri Publik.

Neni 9

Mekanizmat e rinovimit

- 9.1 Pas një periudhe prej 20 vitesh duke filluar nga Data Efektive, Palët bien dakort për të diskutuar pa detyrime, afatet dhe kushtet për zgjatjen e Periudhës së Koncesionit.
- 9.2 Zgjatja e Periudhës së Koncesionit do të jetë e detyrueshme për Palët, në rast se për shkaqe të arsyeshme (jo të shkaktuara nga Koncesioneri) (këtu nuk përfshihet forca madhore) Projekti I propozuar nga Koncesioneri kërkon një periudhë më të gjatë kohe për t'u konsideruar si rentabël dhe financiarisht I përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të 'Vlerës për Para', 'IRR' apo cdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.
- 9.3 Palët bien dakort se Periudha e Koncesionit do të zgjatet për një periudhë të caktuar kohe e barabartë me vonesat e pajustificuara kohore të shkaktuara nga Autoriteti apo cdo Ent Shtetëror, në dhënjen e një license, leje apo autorizimi që kërkohet për përmbushjen e detyrimeve të Koncesionerit, që rrjedh apo ka lidhje me këtë Kontratë.
- 9.4 Palët bien dakort se Periudha e Koncesionit do të zgjatet për një periudhë të caktuar kohe e barabartë me vonesat e pajustificuara kohore të shkaktuara nga Autoriteti, në përmbushje të detyrimeve të tij për dorëzimin e burimit ujqor 'Sasaj', Lukovë, Sarandë.
- 9.5 Palët bien dakort se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, e cila zgjat për një periudhë kohe që e kalon 1 (një) muaj.

Neni 10

Ekskluziviteti

- 10.1 Te Drejtat e Koncesionit do të jenë eskluive dhe Koncesionari do të ketë të drejtën e vetme dhe eskluive të ushtrojë Të Drejtat e Koncesionit të dhëna sipas kësaj Kontrate, në lidhje me përdorimin e ujit te burimit 'Sasaj', Bunec, Sarandë.
- 10.2 Autoriteti, përvecse kur gëzon statusin apo kompetencat e dhëna nga ligji, nuk do të lidhë dhe/ose deklarojë të lidhë cfarëdolloj kontrate apo marrveshje me palë të treta të cilat mund të japin ose të deklarojnë të japin të drejtat e indentifikuara në nenet 5-7 të parashikuara në këtë kontratë, një pale të tretë ose të marrë cdo masë duke përfshirë mbylljen e një kontrate e cila mund të ndikoj negativisht në të drejtat eskluive të dhëna Koncesionerit sipas kësaj Kontrate.

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor “Sasaj, Bunec”, Lukov, Sarandë

- 10.3 Koncesionari do të perdore ujin vetem per qellimet e imbotilimit dhe eksportit rifuxho me anije dhe gjithashtu nepermjet linje transmisioni tubacioni onshore/offshore me stacion pompimi sic parashikohet ne kete kontrate.

Neni 11

Autorizime, Leje dhe Licenca

- 11.1 Autoriteti do të bëjë përpjekje për të siguruar që, cdo Ent Shtetëror nën autoritetin e drejtëpërdrejtë të tij, që i nënshtrohet marrjes së një njoftim me shkrim nga Koncesioneri, do t'i lëshojë Koncesionerit autorizimet, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Koncesionit duke nënkuptuar që Koncesioneri I ka përmbushur kërkesat për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të tilla.
- 11.2 Deri në masën që Autoriteti ose cdo Ent Shtetëror (I cili është nën autoritetin e drejtëpërdrejtë të Autoritetit) nuk ka të drejtë të lëshojë autorizime, leje apo licenca. Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar që autorizimet, lejet dhe licencat t'i lëshohen Koncesionerit në përputhje me këtë Kontratë dhe ligjin e aplikuar, pa vonesa të paarsyeshme, sipas një kërkesë të nevojshme të paraqitur nga Koncesioneri.
- 11.3 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e duhura për të siguruar që të gjitha Entet Shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre respektiv në lidhje me Koncesionerin do të bashkëpunojnë pa vonesa të paarsyeshme, me Koncesionerin në lidhje me zbatimin e Koncesionit.
- 11.4 Koncesioneri do të aplikoj për pajisjen me leje, licenca apo autorizime menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate.
- 11.5 Koncesioneri do të marrë dhe ruajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate të gjitha miratimet, licencat dhe lejet që mund të kërkohen dhe që janë të nevojshme për të mundësuar dhënien e Shërbimit.

Neni 12

Dorëzimi I Mjediseve të Koncesionit dhe Lehtësirave

- 12.1 Me mbarimin e Periudhës së Koncesionit, Koncesioneri do të dorëzojë tek Autoriteti përdorimin e qetë dhe pa asnjë lloj detyrimi, barre apo hipoteke të të gjitha asetëve të realizuara gjatë kësaj periudhe dhe që sipas kushteve të kësaj kontrate duhet të transferohen në pronësi të shtetit.

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

- 12.2 Koncesioneri do të dorëzojë tek Autoriteti objektin në gjendje të plotë funksionale, sic është parashikuar me marrveshjen e ndërshjelltë të palëve.

Neni 13

Procedura e Dorëzimit

- 13.1 Palët bien dakort që në vijim të mbarimit të datës së Periudhës së Koncesionit, cdo e drejtë apo titull i dhënë ndaj Koncesionerit në lidhje me asetet e krijuara do të përfundojë dhe Koncesioneri:
- Do ti kaloj autoritetit cdo të drejtë ose titull në lidhje me asetet e Koncesionit sipas Nenit 12 të kësaj Kontrate.
 - Do ti dorëzoj Autoritetit të gjitha dokumentet dhe të dhënat në posedim të tij në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me operimin e Koncesionit nga Koncesioneri pa pagesa, detyrime apo tarifa të mëtejshme.
- 13.2 Autoriteti bie dakort dhe merr përsipër që brenda 30(tridhjetë) ditëve nga transferimi i të drejtave, titujve në lidhje me asetet dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse sic është parashikuar në paragrafin më sipër, ai do të lëshojë Certifikatën e Dorëzimit në përputhje me Aneksin 1 të Kontrates.

MASAT FINANCIARE

Neni 14

Shpërblimi i Koncesionerit

Shpërblimi i koncesionerit do të përbëhet nga pagesa për përdorimin e mjetit të infrastrukturës (pontilit) për kryerjen e eksportimit të papërpunuar të ujit të burimit 'Sasaj', si dhe nga tregëtimi sipas standarteve të përcaktuara në këtë Kontratë të ujit të pishëm .

Neni 15

Tarifa e koncesionit

Koncesioneri do të paguaj një tarifë (Tarifa e Koncesionit) që arrin në vlerën 2 % të fitimit vjetor të realizuar nga shitjet (duke përjashtuar TVSH-në) brenda dhe jashtë vendit, në favor të Autoritetit për të drejtat dhe privilegjet e dhëna në këtë Kontratë, bazuar në Bilancin Vjetor miratuar nga eksperti kontabel i Shoqërisë Koncesionere për cdo Vit Financiar. Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit. Detyrimi i Koncesionerit për pagesën e kësaj Tarife, fillon nga data e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 16

Modalitetet e pagesës

Tarifa e koncesionit do të paguhet brenda 2 (dy) muajve në përfundim të cdo tremujori të plotë shitjesh, bazuar në bilancin 3-mujor të deklaruar sipas legjislacionit fiskal në fuqi nga Koncesioneri. Palët bien dakord se në përfundim të cdo Viti Financiar do të rakordojnë shifrat financiare për të shmangur cdo pagesë të shtuar apo të munguar të kësaj Tarife.

Neni 17

Kostot dhe shpenzimet e rishikimit

Në rast rishikimi i kostove dhe shpenzimeve të Koncesionit sipas pëlqimit të ndërsjelltë me shkrim të Palëve në përputhje me Procedurën e Kontrollit të Ndryshimit, Palët do të takohen dhe do të diskutojnë mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve brenda 20 ditëve nga marrja e një njoftimi me shkrim nga pala tjetër. Koncesioneri nuk do të jetë i detyruar që të mbajë kosto shtesë në lidhje me ndryshimet e bëra për të vepruar në përputhje me standartet e detyrueshme të hyra në fuqi pas Datës së Ekzekutimit përveçse kur kosto të tilla janë rënë dakort në përputhje me Procedurën e Kontrollit të Ndryshimit.

Neni 18

Financimi i Koncesionit

18.1 Koncesioneri do të bëjë rregullime për një financim të përshtatshëm për qëllime të financimit (qoftë përmes financimit me kredi qoftë përmes pjesëmarrjes së përbashkët) të

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit uxor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

Koncesionit dhe përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate dhe nuk do të kërkohet asnjë autorizim apo miratim i posacëm nga Autoriteti.

- 18.2 Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, Koncesioneri ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të hyjë në cdo lloj marrveshje financimi me cdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionerit në këtë Kontratë.
- 18.3 Koncesioneri ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe cdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesioneri është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni. Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesioneri. Autoriteti nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionerit.

Neni 19

Vlera e riinvestimit

Duke filluar nga viti i 8-të para përfundimit të afatit të kësaj kontrate, Koncesioneri do të riinvestojë 15 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet, sipas një grafiku që është hartuar nga palët në 'Planin e riinvestimit'.

Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 20

Kontrollet financiare

- 20.1 Autoriteti mund, jo më shumë se dy herë në cdo Vit Kontrate lidhur me sa më poshtë, të kryejë kontrolle financiare për të rishikuar cdo dokument financiar të mbajtur nga Koncesioneri lidhur me sigurimin e Shërbimeve;

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit uxor “Sasaj, Bunec”, Lukov, Sarandë

- 20.2 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar që kryerja e secilit kontroll financiar nuk e ndërpret në mënyrë të pa-arsyeshme Koncesionin ose të shkaktojë vonesa në sigurimin e Shërbimeve;
- 20.3 Kushtëzuar nga detyrimet e Autoritetit mbi konfidencialitetit, Koncesioneri do ti sigurojë Autoritetit (dhe / ose përfaqësuesve të tij) të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm dhe ndihmën lidhur me cdo kontroll financiar, duke përfshirë:
- Të gjithë informacionin e kërkuar nga Autoriteti brenda qëllimit të lejuar të kontrollit financiar
 - Mundësi hyrje në cdo Zonë të kontrolluar nga Koncesioneri
 - Mundësi hyrje në ambientet e zbatimit të Projektit
- 20.4 Për qëllimet e kontrollit, Autoriteti duhet të njoftojë paraprakisht Koncesionerin të paktën 15 ditë pune, në lidhje me objektin e kontrollit.
- 20.5 Shpenzimet e kryera për qëllime të kontrollit do të përballohen nga Autoriteti

Në qoftë se një kontroll financiar identifikon që Koncesioneri nuk ka plotësuar një pjesë të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, Palët do të bien dakort dhe zbatojnë një plan riparues.

Neni 21

Sanksionet për vonesat në fillimin e punimeve

- 21.1 Koncesioneri do t'i paguajë Autoritetit një penaltet të barabartë me 50 EUR për cdo javë të plotë në të cilën Koncesioneri dështon në fillimin e punimeve (sic parashikohet në Planin e Projektit):
- 21.2 Shuma maksimale e penalteteve për këto vonesa do të jetë në total 2000 Euro.
- 21.3 Pas pagesë së penalteteve të tilla, nëse Koncesioneri është i suksesshëm në arritjen e afateve të tjera vijuese sipas Aneksit 1, Autoriteti do t'i kthejë Koncesionerit këto Pagesa.

Neni 22

Përfundimi i Punimeve

Koncesioneri do t'i paguajë Autoritetit një penaltet si vijon për cdo javë të plotë në të cilën Koncesioneri dështon në përfundimin e punimeve (sic parashikohet në Planin e Projektit

Java e parë është periudhë falje e si rrjedhim :

Për periudhën në vazhdim 0.05 % në ditë të vlerës së investimit të parezlizuar.

Shuma maksimale e penalteteve për këto vonesa do të jetë në total 2000 (dy mije) Euro.

Nëse Koncesionari nuk përfundon punimet brenda 10 (dhjete) javëve nga data e parashikuar sipas Planit të Projektit, dhe si pasoje e mungesës së arsyeve, Autoriteti nuk miraton planin riparues, apo nuk paraqitet nje plan riparues nga Koncesionari, ky i fundit do te paguaje nje penaltet eventual te caktuar nga autoriteti.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 23

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

- 23.1 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të siguroj vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.
- 23.2 Autoriteti Kontraktues, përvec detyrimeve të parashikuara ne nenin 11, merr përsipër të ndihmojë Koncesionerin në marrdhënje dhe në lidhjen e kontratave me institucionet publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
- 23.3 Te garantoje permbushjen e termave dhe rrethanave te parashikuara ne piken 2 te Nenit 5 te kesaj Kontrate.
- 23.4 Te miratoje brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e paraqitjes prej Koncesionarit, projektin e zbatimit te pregatitur nga Koncesionari, ne perputhje me propozimin per te cilin eshte shpallur fitues ne proceduren e gares. Gjithashtu, brenda ketij afati te miratoje, pas propozimeve te Koncesionarit, modifikime apo ndryshime jo substanciale dhe qe nuk ndryshojne projektin e zbatimit te propozuar dhe te shpallur fitues.
- 23.5 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të garantoj Koncesionerin që ekzekutimi i veprave të tjera të ngjashme në zonën përreth vendit ku ushtron aktivitetin e tij Koncesioneri, nuk do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mbarëvajtjen e projektit të

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

Koncesionerit. Për këtë qëllim, Autoriteti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e efekteve negative që vijnë si rezultat i këtyre ndërhyrjeve dhe që çenojnë rentabilitetin, përshtatshmërinë financiare dhe vlerën në para. Në qoftë se Autoriteti me veprime ose mosveprime nuk përmbush detyrimet e mësipërme dhe si rezultat i kësaj mospërmbushjeje Koncesioneri pëson dëme në mbarëvajtjen e zbatimit të Projektit, atëherë ky i fundit ka të drejtë të kërkojë mbulimin e të gjithë shpenzimeve të kryera për të shmangur ose pakësuar dëmin si dhe shlyerjen e dëmeve të shkaktuara.

Autoriteti është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj Koncesionerit dhe që kanë të bëjnë me Kthimin e Vlerës së Investimit të kryer, sigurimin e kontratës dhe shpërblimin e dëmit për shkak të shkeljes së kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit

Neni 24

Plani i Projektit

Koncesioneri do të sigurojë Shërbimet në përputhje me 'Planin e Projektit'

Neni 25

Programimi i punimeve

- 25.1 Koncesioneri duhet të fillojë aplikimet për marrjen e lejeve dhe licencave të nevojshme menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, përveçse kur kuadri ligjor përkatës parashikon një afat tjetër aplikimi.
- 25.2 Koncesioneri merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Koncesioneri merr përsipër se linja do të vihet në shfytëzim brenda një periudhe kohore prej 14 (katërmbëdhjetë) muajve.
- 25.3 Koncesioneri merr përsipër se nxjerrja në treg e produktit / ujit, do të bëhet brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh nga hyrja në fuqi e kontratës.
- 25.4 Afatet e parashikuara në paragrafët e mësipërm të këtij neni, mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionerit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar pa faj të Koncesionarit përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Neni 26

Testimi

- 26.1 Kur Koncesioneri të konsiderojë se sistemi është gati për tu testuar, ai do të paraqesë sistemin për testim. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim të bërë nga Koncesioneri tek Autoritetit Kontraktues. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionerit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të sistemit. Raporti do të hartohet brenda 30 ditëve nga fillimi i testimit, duke pasur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 26.2 Nëse Koncesioneri i kalon me sukses procedurat e testimit, Autoriteti do të lëshojë një Certifikatë Pranimi. Pavarësisht nga lëshimi i çfarëdo Certificate Pranimi, Koncesioneri do të mbetet i vetmi përgjegjës për të siguruar që Projekti, sic është ideuar dhe zhvilluar, të jetë i përshtetshëm për kryerjen e Shërbimeve, në përputhje me këtë Kontratë.
- 26.3 Në qoftë se gjatë testimit, Autoriteti konstaton mospërputhje thelbësore në realizimin e projektit apo të nivelit të shërbimeve, atëherë ai ka të drejtë të refuzojë lëshimin e Certifikatës së Pranimi, duke përcaktuar një afat rekuperimi. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, pasi Koncesionari e ka lajmëruar zyrtarisht 1 muaj përpara dates se kryerjes së testimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk është paraqitur në mënyrë të shpejtë në rast, Koncesioneri ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga testimi dhe vënien në punë.

Neni 27

Vonesat në zbatim

- 27.1 Nëse, në çdo kohë, Koncesioneri është në gjendje të parashikojë se ai nuk do të arrijë ose ka pak të ngjarë që të arrijë cilindo nga afatet e parashikuara në 'Plani i Projektit', ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin mbi faktin e Vonesës duke bërë një përmbledhje të shpjegimeve përkatëse.
- 27.2 Koncesioneri, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë sesa 10 (dhjetë) ditë pune pas njoftimit fillestar sipas paragrafit të mësipërm, do t'i japë Autoritetit hollësi të plota me shkrim për : a) arsyet e vonesës; b) pasojat e vonesës; c) nëse Koncesioneri

pretendon se vonesa vjen për shkak të Autoritetit duhet të paraqesi edhe arsyen e këtij pretendimi.

27.3 Nëse vonesa i detyrohet një veprimi/mosveprimi të Autoritetit, Konçesioneri do të vërë në përdorim të gjitha burimet shtesë dhe do të marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të shmangur apo zvogëluar pasojat e vonesës. Këto veprime do të kryen aq sa është e mundur dhe e përballueshme financiarisht, me kusht që çfarëdo kostosh të tilla shtesë të pësuara nga Konçesioneri për shkak të Pazotësisë të Autoritetit të jenë miratuar paraprakisht me shkrim nga Autoriteti. Konçesioneri është i detyruar të respektoj këtë procedurë, me përjashtim të një situatë emergjente kur ai për të shmangur efektet negative të vonesës nuk ka kohë të mjaftueshme për të marrë miratimin e Autoritetit. Në këtë rast Konçesioneri do të rimbursohet nga Autoritetit për të gjitha kostot e arsyeshme dhe të nevojshme shtesë të kryera si rezultat i një situatë të tillë.

Neni 28

Zgjidhja e pasojave të vonesës

- 28.1 Cfarëdo konflikti në lidhje me apo si rrjedhojë e vonesave do të zgjidhet përmes procedurës për Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve të parashikuar në nenin 63 të kësaj Kontrate. Gjatë kohës së konfliktit të dyja palët do të vazhdojnë të bashkëpunojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të zvogëluar pasojat.
- 28.2 Në rast se është e mundur, Konçesioneri do të paraqesë një projekt të Platit të Korrigjimit, në rast se nuk është në gjendje të arrijë afatet e parashikuara sipas Projekt Planit Korrigjimit do të identifikojë çështjet që rrjedhin nga vonesa dhe hapat që Konçesioneri propozon që të ndërmerren për të arritur afatet në përputhje me këtë Kontratë.
- 28.3 Projekt Planit i Korrigjimit do t'i paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në cdo rast jo më vonë se 10(dhjetë) ditë pune pas njoftimit fillestar sipas nenit 23.1. Autoriteti mund të refuzoj në mënyrë të paarsyeshme miratimin e tij për një Projekt Plan Korrigjimi.
- 28.4 Konçesioneri do të veprojë në përputhje me Planin e tij të Korrigjimit në vijim të miratimit të tij nga Autoriteti.
- 28.5 Palët bien dakort që marrja nga Konçesioneri dhe/nën-kontraktuesit e tij të të gjitha licencave, autorizimeve dhe lejeve të kërkuara për ekzekutimin e projektit do të jenë të një natyre thelbësore për vënien në jetë të kësaj Kontrate. Në rast vonese për më shumë se 45 ditë në marrje e licencave, autorizimeve dhe të lejeve të tilla (nga organet kompetente) pas

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit uxor “Sasaj, Bunec”, Lukov, Sarandë

datës së aplikimit nga Koncesioneri (të një aplikimi të plotësuar saktësisht) dhe / ose më shumë se 7 ditë në marrjen nga Autoriteti të cdo dokumenti të nevojshëm për sigurimin e këtyre licensave, autorizimeve dhe lejeve të kërkuara, Koncesioneri nuk do të quhet se është në vonesë sipas kësaj Kontrate për ato vonesa që rrjedhin nga licenca e vonuar duke u clikuar nga cfarëdo penaliteti apo pasoje të vonesës sipas kësaj Kontrate që rrjedh nga licenca e vonuar dhe Periudha e Koncesionit do të zgjatet në përputhje me periudhën e vonesës, nëse Palët nuk arrijnë një zgjidhje tjetër.

Neni 29

Vonesat në arritjen e Planit të Projektit për shkak të Autoritetit

- 29.1 Nëse Koncesioneri nuk i ka arritur afatet e parashikuara nga palët në ‘Planin e Projektit’ si rezultat i një Shkakut të Autoritetit, atëherë pasi Koncesioneri të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim Autoritetin mbi shkakun e vonesës, ai do të përfitojë nga të drejtat dhe lehtësirat e parashikuara në këtë nen si :
- Sipas paragrafit të mëposhtëm do ti lejohet një shtrirje e afatit e barabartë me Vonesën e shkaktuar për shkak të Autoritetit;
 - Mosarritja për të respektuar afatet e parashikuara në ‘Planit të Projektit’, nuk dot të quhet shkelje e kësaj Kontrate, dhe do te zbatohet dispozitat e nenit 21 te kesaj Kontrate;
 - Nuk do të ketë përgjegjësi për pagimin e penaliteteve, në lidhje me mosarritjen e afateve në masën që Vonesa vjen drejtëpërdrejtë nga Shkakut i Autoritetit;
 - Do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime për shpenzimet e kryera për shkak të Autoritetit, në përputhje me parashkimet e nenit 23.3
- 29.2 Në një rast të tillë Autoriteti duhet të:
- marrë në konsideratë kohëzgjatjen e vonesës, natyrën e pazotësisë së Autoritetit dhe pasojën e vonesës si edhe të pazotësisë të Autoritetit mbi aftësinë e Koncesionerit për të vepruar në përputhje me Planin e Projektit;
 - këshillohet me Përfaqësuesin e Koncesionerit në përcaktimin e pasojës së vonesës dhe në atë se si të pakësohen pasoja të tilla atje ku kjo mund të praktikohet në mënyrë të arsyeshme;
 - caktoj një Datë të Rishikuar të Afateve; dhe
 - (nëse është e përshtatshme) , të bëjë cdo rishikim vijues ndaj afateve vijuese në Planin e Projektit

- 29.3 Autoriteti nuk do të vonohet paarsyeshmërisht kur të marrë në shqyrtim dhe kur të përcaktojë pasojën e një vonese sipas këtij neni ose në rënien dakord për një Ndryshim sipas Proedurës së Ndryshimit të Kontratës. Në të gjitha rastet ky afat nuk mund të kalojë periudhën kohore prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh.

Neni 30

Monitorimi dhe Mbikqyrja

- 30.1 Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitoim në cdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate.
- 30.2 Autoritetit Kontraktues, ka të drejtë të ushtroj një mbikqyrje të përgjithshme me afate tremujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë ecurinë e punimeve, cilësinë dhe përshtatshmëria të jetë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit. Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 31

Shërbimet

- 31.1 Koncesioneri do të sigurojë që projekti të jetë në përputhje me: të gjitha aspektet të Kërkesave të Autoritetit, këtë Kontratë, Aneksat e parashikuara në këtë kontratë.
- 31.2 Koncesioneri do të zbatoj projektin dhe do të ofrojë shërbimet e tij në përputhje me :
- Praktikën e Industrisë së Përparuar
 - Politikën e Sigurisë
 - Planin e Cilësisë
 - Nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikqyrjes, kontrollit dhe gjykimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesionale me përvojë në dhënien e shërbimeve të tipit dhe kompleksitetit të kërkuar nga Autoriteti sipas kësaj Kontrate.



Neni 32

Pasoja e Shkakut të Autoritetit në Fazën Operacionale

Nëse Koncesioneri do ti ofronje Shërbimet Operacionale në përputhje me këtë Kontratë, por ka dështuar të bëjë kështu si rezultat i Shkakut të Autoritetit, Koncesioneri do të ketë të drejtat e dhe asistencën e parashikuar më poshtë :

- Do të trajtohet si në rastin që Shërbimi i përshtatshëm ka arritur nivelin e shërbimit të përshtatshëm; dhe
- Nuk do të trajtohet si të jetë në moszbatim të kësaj Kontrate për përmbajtjen që mosekzekutimi ose prishja është për shkak të Autoritetit; dhe
- Do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime për shpenzime të kryera nga Koncesioneri për shkak të Pazotësisë të Autoritetit me kusht që çfarëdo shmenzimi i tillë shtesë të jetë miratuar paraprakisht me shkrim se po shkaktohet nga Autoriteti, përveçse në rastin e një emergjence kur Koncesioneri ka nevojë të përballet me shpenzime kur nuk ka kohë të mjaftueshme për të marrë miratimin Koncesioneri do të rimbursohet për kosto të tilla të arsyeshme e të nevojshme shtesë.

Neni 33

Nëse Koncesioneri pretendon se zbatohet neni 35 i kësaj Kontrate, dhe me qëllim që të pretendojë të drejtat dhe asistencat e parashikuar në të , do të pajisë Autoritetin me detajet e Shkakut të Autoritetit si pjesë e informacionit të menaxhimit që është i detyruar që të sigurojë.

Neni 34

Cdo konflikt që lind si rezultat i pazotësisë së Autoritetit për sigurimin e Shërbimeve në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe /ose këtë Kontratë do të zgjidhet përmes Procesurës së Zgjidhjeve të Konflikteve. Në pritje të zgjidhjeve të konflikteve të dyja palët do të vazhdojnë të zgjidhin çështjet dhe të zbusin efektet e këtij dështimi.

Neni 35

Përmirësimi i shërbimeve

Koncesioneri ka të drejtë që gjatë gjithë kohës të identifikojë përmirësime të reja ose potenciale të Shërbimeve në pajtim me këtë Nen. Në këtë kuadër Koncesioneri, ka të drejtë të identifikojë dhe raportojë pranë autoritetit, për:

- Nevojën e teknologjive përkatëse të reja dhe të zhvilluara, të cilat mund të përmirësojnë sistemin dhe/ose Shërbimet, dhe këto teknologji të zhvilluara potencialisht të mundshme për Koncesionerin dhe Autoritetin, të cilat Palët duan të adoptojnë; dhe /ose
- Përmirësime të reja ose të mundshme të shërbimeve duke përfshirë cilësinë, përgjegjshmërinë, procedurat, si mekanizmat e performancës dhe shërbimet mbështetëse të klientit në lidhje me Shërbimet.

Neni 36

Koncesioneri do të sigurojë që informacioni që do ti jepet Autoritetit të jetë i mjaftueshëm për Autoritetin që të përcaktojë nëse ndonjë përmirësim duhet të zbatohet. Koncesioneri do të jap cdo informacion të mëtejshëm që Autoritetit kërkon.

Nëse autoriteti dëshiron të përfshijë ndonjë përmirësim të identifikuar nga Koncesioneri, Autoritetit do ti dërgojë Koncesionerit një Kërkesë Ndryshimi dhe palët do:

- Zhvillojnë një plan për zbatimin e përmirësimeve brenda një afati 20 dite pune të Kërkesës së Ndryshimit të Autoritetit, për Aprovimin e Autoritetit;
- Zbatojnë përmirësimin në përputhje me parashikimet e një plani të zbatimit, i miratuar nga Autoriteti

Neni 37

Rishikimi i shërbimeve

Në cdo kohë , secila Palë ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që të hyjë në diskutime në lidhje me rishikimin e Shërbimeve dhe gjithë ndryshimet e rena dakort do të vihen në jetë përmes Procedurës për Kontrollin e Ndryshimit, por pa negociuar për sasinë e ujit dhe parametrat dhe zgjidhjen e kaptazhit të parashikuara në këtë kontratë

Neni 38

Rregjistra dhe Raporte

Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Aneksit 1 (Kërkesat e Autoritetit) dhe (Propozimi i Ofertuesit) lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe bërjen e raporteve. Konçisioneri do të sigurojë Autoritetit mbi një bazë të rregullt në mënyrë dhe formë të atillë dhe në mënyrë të shpeshtë sic mund të përcaktohet me hollësi nga Autoriteti.

Neni 39

Kontrolli i Ndryshimit

Cdo kërkesë për Ndryshim do ti nënshtohet Procedurës së Kontrollit të Ndryshimit.

Nëse pas ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate hyn në fuqi, nxhirret apo shtohet cfarëdo ligji, rregulloreje, urdhëresë apo procedurë që ka fuqinë e ligjit në Republikën e Shqipërisë, dhe ndikon kushtet/ afatet e Kontratës, por gjithmonë duke përjashtuar ndryshime të tilla të cilat ndikojnë në të gjitha bizneset në Shqipëri të tilla si ndryshime në ligjin për taksat, palët do të rishikojnë ato kushte apo afate të cilat ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të Konçisionerit sipas Procedurës për Kontrollin e Ndryshimit. Në cdo rast rishikimi i afateve apo kushteve duhet të synojë vazhdimësinë e kontratës dhe krijimin e lehtësirave të nevojshme për zbatimin e këtij projekti konçisioner

Neni 40

Personeli

Konçisioneri do të sigurojë që ai ka personel të mjaftueshëm në mënyrë që të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë.

Konçisioneri do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar vazhdimësinë e personelit dhe për të siguruar që shkalla e ndërrimit të personelit kryesor të përfshirë në sigurimin ose menaxhimin e shërbimeve është së paku po aq e mirë sa edhe standartet e industrisë për një Konçisioner që është duke operuar me Praktikën e Industrisë së Mirë për shërbime, zona dhe rrethana të njejta.

Konçisioneri pranon që personeli kryesor është i rëndësishëm dhe themelor për ofrimin e sigurimeve të duhura ndaj Autoritetit. Konçisioneri do të sigurojë që cdo zëvendësim do të jetë i

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

kualifikuar dhe me përvojën e përshtatshme dhe tërësisht kompetent për të zbatuar detyrat e caktuara të Personelit Kyc të cilin ai ose ajo e ka zëvendësuar.

Neni 41

Të drejtat e Koncesionerit

Përvec të drejtave që lindin nga dhënia e Koncesionit, Koncesioneri gëzon të drejtat e mëposhtme:

- Të ushtrojë të gjitha të drejtat në lidhje me përdorimin ekskluziv të burimit ujqor "Sasaj", Bunec, Sarandë dhe zotërimin e lirë të zonës ku do të zbatohet projekti.
- Të punësojë apo angazhojë punonjës, përfshirë personelin kryesor, me qëllim zbatimin e Koncesionit si dhe të hartojë politikën e vetë të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë Kontratë.
- Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur detyrimet dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate.
- Të negociojë për rinovimin e Periudhës së Koncesionit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate;
- Të zgjasë Periudhën e Koncesionit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

Neni 42

Detyrime të përgjithshme të Koncesionerit

Detyrime të përgjithshme të koncesionerit:

- Të zbatojë Koncesionin në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe shtojcat e saj;
- Te marri përsiper negocimin dhe koston financiare të shpronësimit të tokës ku do të ndërtohet impianti i trajtimit dhe imbotilimit të ujit.
- Përvec rasteve kur shprehet ndryshe në këtë Kontratë ose kur është rënë dakord ndryshe mes Palëve, Koncesioneri do të mbulojë kostot dhe shpenzimet që shoqërojnë përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë Kontratë dhe Aneksat e saj;
- Përvec kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë dhe në Ligj, Koncesioneri do të aplikojë dhe paguajë, marrë dhe ruajë të gjitha autorizimet, lejet dhe licencat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

- Koncesioneri do të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nënkontraktorit (sipas kontratave përkatëse që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Anekset e saj.

Pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, pasuritë e krijuara apo rindërtuara apo të zhvilluara posacërisht ose të përdorura nga Koncesioneri do t'i kalohen Autoritetit pa pagësë shpërblimi nga Autoriteti për Koncesionerin, në zbatim të nenit 5 të kësaj Kontrate.

Neni 43

Detyrime të Posacme të Koncesionerit

Koncesioneri është i detyruar :

- Të siguroj cilësi të lartë, besueshëmri dhe qëndrueshmëri të Shërbimeve gjatë periudhës së Koncesionit;
- Të informojë Autoritetin në çfarëdo rrethane që mund të dëmtojë procesin e zbatimit të Koncesionit
- Të zbatojë teknologji të përshtatshme për kapjen e burimeve ujore, të cilat nuk cënojnë regjimin e ujrave në afërsi të burimit ujqor 'Sasaj', Lukovë, Sarandë. Në këtë mënyrë kërkohet që shpimi i galerive përkatëse të kryhet duke mos përdorur lëndë shpërthyesë dhe / ose plasëse dhe gjithmonë nën mbikqyrjen e specialistëve përkatës të kësaj fushe, të licensuar për këtë qëllim.
- Të raportojë cdo 6 muaj tek Autoritetit në lidhje me përparimin e realizuar në zhvillimin e Koncesionit, sic përcaktohet në këtë Kontratë;
- Të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme me qëllim garantimin e kusheve të sigurisë në punë për punonjësit e tij si dhe të njohë legjislacionin që lidhet me parandalimin e dëmeve dhe fatkeqësive
- Të marrë masa për të garantuar mbrojtjen e mjedisit gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Neni 44

Forca Madhore

Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore, katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike e biologjike dhe cdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

tyre dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve, por duke patur parasysh se:

- Ngjarje të tilla nuk mund të parshikoheshin apo shmangeshin, pavarësisht kujdesit të arsyeshëm të treguar nga pala e dëmtuar;
- Pala e dëmtuar mori ose kishte marrë të gjitha masat paraprake e arsyeshme, për të shmangur pasojat e kësaj ngjarjeje, që solli si pasojë paaftësinë e kësaj pale për të përmbushur detyrimet e Kontratës.
- Ngjarja nuk është ose nuk ishte, drejtëpërsëdrejti ose jo, rezultati i ndonjë mospërmbushje detyrimesh të parashikuar në këtë Kontratë.

Neni 45

Pasojat e Ngjarjeve të Forcës Madhore

Në rastet e forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 5 (pese) ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyerjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Neni 46

Në rastin e ndodhjes së cfarëdo Ngjarje të Forcës Madhore, do të zbatohen sa vijon:

- Nuk do të ketë asnjë përfundim të kësaj Kontrate përveçse kur parashikohet në nenet në vijim.
- Në rastin e një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh përpara Datës Efektive, afati për arritjen e Datës Efektive do të shtrihet në periudhën për të cilën Ngjarja e Forcës Madhore do të vazhdojë;
- Në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh pas Datës Efektive, Periudha e Koncesionit do të zgjatet për kohëzgjatjen e një Ngjarjeje të tillë të Forcës Madhore;

Përveçse për dispozitat e nenit 39 të kësaj Kontrate, Autoriteti mund që t'i rimbursojë kostot e Forcës Madhore, Koncesionerit në monedhë apo të kompensojë Koncesionerin për të tilla kosto me anë të shtrirjes së përshtatshme të Periudhës së Koncesionit.

Neni 47

Dëmshpërblimi

Autoriteti do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe ruajë Koncesionerin të pacënuar nga ndonjë dhe cdo lloj procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të cfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Autoritetit, zyrtarëve, nënpunësve dhe agjentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Autoritetit sipas kësaj Kontrate, përveçse në shkallën që një pretendim i tillë ka lindur për shkak të shkeljes nga Koncesioneri të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

Koncesioneri do të dëmshpërblejë dhe do të vazhdojë të dëmshpërblejë Autoritetin gjatë Periudhës së Koncesionit nga dhe kundër ndonjë dhe cdo procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të cfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Koncesionerit sipas kësaj Kontrate, përveçse në shkallën që kjo humbje ose ky dëm lind nga shkelja e ndonjë dispozite të shprehur të kësaj Kontrate nga Autoriteti ose ndonjë Organ Shtetëror ose ndonjë veprim ose mosveprim i qëllinshëm i autoritetit ose i ndonjë Organi Shtetëror;

Pala që shkakton një shkelje të kësaj Kontrate do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të pakësuar humbjen, dëmin që ka ndodhur, me kusht që pakësimi i humbjes ose lehtësimi i dëmit të mund të bëhen pa vështirësi ose kosto të paarsyeshme.

Neni 48

Konfidencialiteti

- 21.1 Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjese të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.
- 21.2 Paragrafi i mësipërm nuk do të zbatohet në shkallën që :
- Ky informacion ka qënë në zotërim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;
 - Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;
 - Ky informacion ka qënë për përdorim publik në kohën e zbulimit ndryshe nga shkelja e kësaj Kontrate; ose
 - Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerrë sipas ligjit

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

21.3 Asgjë në këtë Kontratë nuk do e pengojë Autoritetin të zbulojë nga Informacioni Konfidencial i Koncesionerit:

- Ndaj cilitdo enti qeveritar. Të gjitha entet qeveritare që marrin këtë Informacion Konfidencial do të kenë të drejtë t'jajapin më tej Informacionin Konfidencial departamenteve të tjera qeveritare, mbi bazën që informacioni të jetë konfidencial dh të mos i zbulohet një palë të që nuk është pjesë e departamentit qeveritar ose e një Autoriteti.
- Mbi bazën e 'nevojës për njohuri' nga konsulenti, kontraktori ose ndonjë person tjetër të angazhuar nga Autoriteti me kusht që një person i tillë të bjerë dakord që ta ruajë këtë informacion di konfidencial.

Neni 49

Kufizimet në Përgjegjesi

Koncesioneri nuk e kufizon përgjegjësinë e tij për :

- Vdekjen ose plagosjen personale të shkaktuar nga neglizhenca e tij ose nga neglizhenca e punonjësve, agentëve ose nënkontraktorëve të tij; ose
- Mashtrimin nga ana e tij ose nga punonjësit e tij.

Neni 50

Kufijjtë financiare

Kufijjtë financiare të penalteteve që duhet të paguajë Koncesioneri për moszbatim të afateve të parashikuara në Plani i Projektit, janë ato të miratuara ndërmjet palëve në nenet 21, 22 të kësaj Kontrate. Palët bien dakort shprehimisht që nëse ndonjë kufizim ose kusht në përmbajtje të kësaj dispozite ose i referuar shprehimisht në këtë nen cmohet si i pavlefshëm sipas ndonjë Ligji, do të konsiderohet i përjashtuar në atë shkallë dhe nëse ndonjë Palë është përgjegjëse për humbjen ose dënim për të cilin është zbatuar ai kufizim ose kusht, ajo përgjegjësi do t'i nënshtrohet kufizimeve dh kushteve të mbetura të përcaktuar në këtë nen.

Neni 51

Sigurimi

Me qëllim zbatimin me sukses të këtij Projekti dhe garandimin e një aktivitetit të pandërprerë, Koncesioneri duhet të bëjë përpjekjet e duhura me qëllim sigurimin e aseteve nga ngjarje, rrethana apo Forca Madhore (aq sa mund të jenë).



Neni 52

Garancitë e Autoritetit

Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Kontate dhe gjatë Periudhë së Koncesionit:

- Ai ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë Kontratë dhe për të kryer transaksionet e parashikuara në të;
- Kjo Kontatë përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj;
- Do të mbrojë dhe nuk do të dëmtojë Koncesionerin nga të gjitha pretendimet juridike të palëve të treta në lidhje me zotërimin paqësor (prosedimin si pronë) të vendeve dhe aseteve të Koncesionit;

Ekzekutimi, realizimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk do të krijojë konflikte, nuk do të rezultojë në shkelje dhe nuk do të përbëjë kundravajtje apo të përshpejtojë realizimin që kërkohet nga çfarëdo kushti i ligjeve në fuqi apo kontatave, konventave, dekreteve apo urdhrave tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim

Neni 53

Garancitë e Koncesionerit

Koncesioneri deklaron dhe garanton tek Autoriteti se, që nga data e ekzekutimit të kësaj Kontate dhe gjatë Priudhës së Koncesionit:

- Ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë kontatë dhe për të kryer transaksionet e parashikuara në të;
- Ka pozitë dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë Koncesionin;
- Do të përmbushë detyrimet e tij me zellin e duhur profesional;
- Nuk është falimentuar dhe është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe dispozitat e kësaj Kontate.



Neni 54

Sigurimi i Kontratës

Konçesioneri, me shpenzimet e tij, do t'i sigurojë Autoritetit një Sigurim Kontrate të lëshuar nga një institucion bankar apo shoqëri sigurimesh, që ushtron aktivitetin e saj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për një shumë të barabartë me 10 % të vlerës totale të investimit, sipas formës së parashikuar .

Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Konçesionerit në lidhje më përfundimin e punimeve të ndërtimit dh përfundimin e testimit, në përputhje me parashikimet e nenit 22.

Autoriteti do të lëshojë Sigurimin e Kontratës për Konçesionerin pas kalimit të një periudhe prej 30 ditësh që nga data e mbarimit apo kalimit të kësaj Kontrate me kusht që Konçesioneri të mos jetë në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

Neni 55

Formula e sigurimit të kontratës

Formulari i Sigurimit të Kontratës do të zvogëlohet nga Konçesioneri në përputhje me formulën në vijim:

- a) 25 % të vlerës së Sigurimit, brenda ditëve nga realizimi i fazës së parë të projektit;
- b) 25 % të vlerës së Sigurimit, brenda ditëve nga realizimi i fazës së dytë të projektit;
- c) 25 % të vlerës së Sigurimit, brendaditëve nga realizimi i fazës së tretë të projektit;
- d) 25 % të vlerës së Sigurimit, brendaditëve nga realizimi i fazës së katërt të projekti

Neni 56

Nën-kontraktimi

Konçesioneri nuk do të nënkontraktojë asnjë nga deyrimet e tij sipas kësaj Kontrate më shumë se 30 % të vlerës së kontratës, pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit. Për mënyrë të miratimit

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ ose dërgesave nuk do të konsiderohen nën-kontraktorë sipas kësaj Kontrate.

Koncesioneri do të pajisë Autoritetin me informacionin e mëposhtëm për nën-kontraktuesin e propozuar :

- Emrin e tij dhe adresën
- Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë qëllimin e cdo shërbimi që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- Cdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti.

Neni 57

Transferimi i Kontratës

Koncesioneri nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë, përveç se kur një transferim i tillë miratohet me shkim nga Autoriteti Kontraktues.

PËRFUNDIMI I KONTRATËS

Neni 58

Mbarimi i kontratës

Kontrata e koncesionit mbaron me përfundimin e afatit 20 vjeçar.

Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Koncesionerin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 59

Zgjidhja e kontratës nga Autoriteti

Autoritetit , në rast se nuk është parashikuar në këtë Kontratë, i jepet e drejta për të përfunduar këtë Kontratë kur:

- Koncesioneri është në shkelje të detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, pas një periudhe prej 100 ditësh nga njoftimi i kësaj shkeljeje, me anë të një njoftimi me shkrim;
- Pas javës së gjashtë të vonesës , Koncesioneri nuk fillon ose nuk mbaron punimet sipas 'Planit të Projektit'.

Neni 60

Zdhidhja e kontratës nga Koncesioneri

Koncesioneri, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, ka të drjtë ta përfundojë këtë Kontratë kur Autoriteti është në shkelje që e ben te pamundur vijimin e kësaj Kontrate dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, pas një periudhe prej 30 ditësh nga njoftimi i kësaj shkeljeje, me anë të një njoftimi me shkrim.

Neni 61

Zgjidhja e kontratës nga të dyja palët

Në rast se Data Efektive nuk hyn në veprim brenda një periudhe prej 90 (nentedhjetë) ditësh që nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, secila nga Palët do të ketë të drejtën që të përfundojë atë duke dhënë një Njoftim Zgjidhjeje ndaj Palës tjetër. Në vijim të marrjes së një Njoftimi Zgjidhjeje të tillë, Palët në këtë Kontratë nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme sipas kësaj Kontrate përvec atyre të parashikuara në nenin 48 dhe nenin 74.

Nëse një Forcë Madhore vazhdon për një periudhë më të gjatë se 1(nje) muaj të njëpasnjëshëm, secila Plaë mund të përfundojë këtë Kontratë, duke i dhënë një Njoftim Përfunimi Palës tjetër.

Neni 62

Njoftimi i përfundimit

Secila nga Palët që i japin fund kësaj Kontrate në rastet e parashikuara në të, do ta bëjë këtë me anë të një Njoftimi me shkrim, i cili i dërgohet Palës tjetër (Njoftim Përfundimi). Njoftim Përfundimi duhet të përmbajë :

- Detajet e duhura duke nënvizuar Ngjarjen e Shkakut;
- Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;
- Cdo informacion tjetër të rëndësishëm.

Neni 63

Procedura e zgjidhjes së mosmarrveshjeve

Nëse ndërmjet Autoritetit dhe Koncesionerit do të lindë ndonjë çështje që përbën shqetësim, atëherë Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zgjidhur një çështje të tillë në mënyrë sa më të shpejtë dhe praktike që të jetë e mundshme, në atë nivel që një mosmarrveshje e tillë do të krijohet. Minimalisht, palët do të sigurojnë se e kanë diskutuar çështjen në dritën e fakteve që lidhen me çështjen, që e kanë kaluar atë nëpër nivelet operative, menaxheriale dhe ekzekutive të shqyritimit (sipas mundësisë) dhe se kanë bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të arritur në një zgjidhje.

Neni 64

Procesi i shkallëzimit

- 64.1 Kur Palët nuk arrijnë një zgjidhje për mosmarrëveshjen, ato do të përpiqen t'i zgjidhin në funksion të përshkallëzimit të mosmarrveshjes, duke përdorur Procesin e Shkallëzimit , përpara nisjes së një procedure alternative të zgjidhjes së mosmarrveshjes nëpërmjet emërimit të një eksperti apo grupi ekspertësh.
- 64.2 Kur lind një çështje, e cila nuk mund të zgjidhet në atë nivel që kjo çështje lind, atëherë autoritetit ose Koncesioneri mund ta dërgojnë atë par në nivelin tjetër në procesin e Shkallëzimit.
- 64.3 Procesi i Shkallëzimit synon të jetë një udhëzues për palët lidhur me zgjidhjen e çështjeve në mënyrë po aq të shpejtë sa ato lindin. Synimi nuk është që Procesi i Shkallëzimit të funksionojë në mënyrë jo fleksibël apo në një mënyrë të tillë që pengojë zgjidhjen e një çështje në nivelin më të përshtatshëm dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.

- 64.4 Kur, në cdo nivel, vendoset që çështja ka kaluar nëpër shkallë sipas mënyrës së duhur, Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zgjidhur çështjen.
- 64.5 Kur pranohet një zgjidhje, vendimi së bashku me planin e zbatimit do të raportohen me shkrim.
- 64.6 Kur një çështje nuk mund të zgjidhet në një nivel, atëherë ajo do të kalohet në nivelin tjetër më të lartë në përputhje me Paragrafin 64.2.

Neni 65

Procedura e Shkallëzimit

- 65.1 Përveç rastit kur një çështje kërkon zgjidhje të shpejtë, ku veprimet e Autoritetit janë ose mund të ndikohen negativisht ose kur secila Palë mund të pësojë kosto domethënëse si rezultat i moszgjidhjes së çështjes, referimi i çështjes do të bëhet me raport të shkruar për tek nivelin tjetër nga Pala e cila referon çështjen. Raporti do të përmbajë, të paktën informacionin e mëposhtëm:
- Emrin dhe adresën e iniciatorit;
 - Data kur është ngritur çështja për herë të parë
 - Përshkrimi i çështjes, duke përfshirë cdo histori me probleme të ngjashme;
 - Implikimet e çështjes, seriozitetin e saj dhe shkallën e urgjencës që kërkohet;
 - Një vlerësim të kostos aktuale dhe potenciale të çështjes ;
 - Emrat dhe adresat e të tjerëve të përfshirë, të cilët mund të ketë nevojë të konsultohen
- 65.2 Brenda 5 dite pune nga marrja e vendimit për shkallëzimin, iniciatori dhe homologu i tij do të përgatisin dhe pranojnë një raport për nivelin tjetër dhe homologut do t'i jepet një kopje e raportit. Kur raporti nuk mund të pranohet, atëherë cdo vërejtje shtesë që mund të kërkojë Pala tjetër, do t'i bashkëlidhet raportit.
- 65.3 Sapo raporti të jetë dorëzuar, personat përkatës të nivelit të dhënë do të kontaktojnë me njeri-tjetrin sa më shpejt që të jetë e mundur për të zgjidhur çështjen që është subjekt i referimit brenda një periudhe shtesë prej 5 ditësh pune pas së cilës çështja do të referohet në nivelin pasardhës ose, do të zbatohen, në vijim të referimit të nivelit 4, procedurat e përcaktuara në paragrafët 64.2, 64.3, 64.4.

Nivelet e shkallëzimit janë si vijon:

| Niveli | Autoriteti | Koncesioneri |
|----------|------------|--|
| Niveli 1 | | Menaxheri i Përgjithshëm i Shoqërisë Koncesionere. |
| Niveli 2 | | Drejtori i Përgjithshëm i Projektit. |

Neni 66

Pasojat e Përfundimit

Mbarimi i afatit të përfundimit, apo të përfundimeve të tjera të kësaj Kontate (sido që të ndodhë ajo), nuk duhet të çënojë të drejtat apo ligjshmërinë e cdonjerës prej palëve, as dhe hyrjen në fuqi apo vazhdimësinë e ndonjë dispozite në këtë Kontrate, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të hyjë në fuqi apo të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të afatit të përfundimit, ose të Përfundimit të Pjesshëm, që përfshin pa kufizim dispozitat e nenit ‘Konfidencialiteti’, ‘Kufizimet për Përgjegjshmërinë’, Pasojat e Përfundimit, Ndarja, Kontrata si një e tërë, Të Drejtat e palës së Tretë, Ligji rregullues dhe Juridiksioni, duhet të veprojë edhe pas përfundimit apo mbarimit të kësaj Kontrate.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 67

Marrveshja e Palëve

Asgjë në këtë Kontratë nuk ka për qëllim që të krijojë një ortakëri apo një marrdhënie ligjore të cfarëdo lloji që mund të shtonte përgjegjësi mbi njërën Palë për veprimin apo mosveprimin e Palës tjetër apo që të autorizonte secilën nga Palët që të veprojë si agjentë për Palën tjetër. Asnjëra nga palët nuk do të ketë Autoritetin që të bëjë përfaqësime apo të veprojë në emër të Palës tjetër apo të angazhojë palën tjetër në cfarëdo mënyre.

Neni 68



Ndarja

Nëse cilado nga dispozitat e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për çfarëdo arsye dhe nga cilado gjykatë apo juridiksion kompetent, kjo dispozitë do të ndahet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohet se është e pavlefshme në çfarëdo shtrirje, Koncesioneri dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

Neni 69

Sigurime të mëtejshme

Secila Palë merr përsipër me kërkesën e Palës tjetër dhe me shpenzimet e Palës që e kërkon që të kryejë të gjitha veprimet dhe të zbatojë të gjitha dokumentat që mund të jenë të nevojshme për të dhënë fuqi kuptimit të kësaj Kontrate.

Neni 70

Kontrata si një e tërë

- 70.1 Kjo Kontratë, së bashku me dokumentat të cilëve i bëhet referim në të, përbën Kontratën si një e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me çështjet e trajtuara në të dhe sundon mbi, zhvlerëson dhe shfuqizon çdo Kontratë të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me çështje të tilla pavarësisht nga termat e cilitdo rregullim apo cilëndo Kontratë të mëparshme që kanë shprehur se nuk do të përfundojnë.
- 70.2 Secila nga palët njeh dhe bie dakort se me hyrjen në këtë Kontratë dhe në dokumentat e referuar në të, ajo nuk do të përfitojë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë, çfarëdo deklaratë, përfaqësimi, garancie apo detyrimi të marrë përsipër (qoftë e bërë nga neglizhenca apo pa faj) të ndryshme nga sa është thënë në mënyrë të shprehur në këtë Kontratë. Rregullimi i vetëm i mundshëm për secilën palë në këtë Kontratë në lidhje me deklaratime, përfaqësime, garanci apo kuptime të tilla do të jenë për raste të shkeljes së kontratës sipas termave të kësaj Kontratë.

Neni 71

Të drejtat e Palëve të treta

Duke iu referuar dispozitave mbi Konfidencialitetin, një person që nuk është palë në këtë Kontratë nuk ka të drejtë të zbatojë asnjë nga kushtet e kësaj Kontrate por kjo nuk prek çfarëdo të drejte apo rregullimi të cdo personi i cili ekziston apo është bërë i disponueshem në vijim të një Akti të ndryshëm nga ky.

Neni 72

Njoftimet

Cilatdo Njoftime të dhëna sipas apo në lidhje me këtë Kontratë do të jenë me shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Palës që e bën njoftimin dhe do të njoftohet përmes dërgimit personalisht apo dërgimit të rregjistruar të parapaguar apo poste të rregjistruar në adresën dhe në vemendjen e Palës përkatëse për këtë qëllim apo në atë adresë që Pala mund të ketë përcaktuar në përputhje me këtë Nen. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike.

Cdo Kërkesë për Ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar.

Do të quhet se një njoftim është marrë :

- Nëse është dërguar personalisht, në kohën e dërgimit; dhe
- Në rast të dërgimit të parapaguar me postë të klasi të parë, tre ditë pune që nga dita e postimit.

Në të provuarit e shërbimit, do të jetë e mjaftueshme të provohet se zarfi që përmbante njoftimin u dërgua në adresën e Palës përkatëse në adresat e njoftuara paraprakisht për marrjen e njoftimeve (ose sic është njoftuar ndryshe nga ajo Palë) dhe u dërgua ose në atë adresë ose në ruajtjen e autoriteteve të postës si postë e parapaguar e klasit të parë, dërgim i rregjistruar, postë e rregjistruar apo letër e dërguar me poste ajrore.

Neni 73

Rregullimi

Paët bien dakort që të menaxhojnë këtë Kontratë përmes dispozitave mbi rregullimin të përcaktuara në Kërkesat e Autoritetit (Ftesa për Ofertë e publikuar më 04.10.2013) dhe Zgjidhja e

Kontratë Koncesioni i formës BOT, i burimit ujqor "Sasaj, Bunec", Lukov, Sarandë

Koncesionarit (Dokumentet e Ofertës së paraqitur të datës 28.10.2013); apo sipas ndonjë marrveshje të mëposhme të vendosur me pëlqimin reciprok të palëve.

Neni 74

Ligji rregullues dhe Juridiksioni

- 74.1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 74.2 Cdo kundërshti, mosmarrveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 74.3 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e cdo mosmarrveshje që lidet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 74.4 Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 75

Kopjet e hartuara

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4(kater) kopje të cilat kanë të njejtën vlerë ndërmjet tyre.

Neni76

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të palëve në prani të noterit publik

Per: "BLUE EYE ONE" Sh.p.k

Për: MINISTRINË E MJEDISIT

Administratore

Znj. Sofije MERKAJ

Blue Eye One

Tirane - Albania

ANEKSI 1:

Procedura e Ndryshimeve të Kontratës

Neni 1

Parime të përgjithshme

Ky aneks përcakton procedurën për trajtimin e Ndryshimeve të kësaj Kontrate.

Pa paragjykuar asnjë nga dispozitat e kësaj Kontrate, të dy palët:

- pranojnë nevojën për të vepruar në mënyrë të arsyeshme në të gjitha rastet lidhur me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve të Kontratës; dhe
- marrin përsipër të veprojnë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve të Kontratës.

Neni 2

Kërkesa për Ndryshim

Secila palë mund t'i bëjë një Kërkesë për Ndryshim palës tjetër në cdo kohë gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës. Kërkesa për Ndryshim duhet të jetë me shkrim dhe të përmbajë :

- Datën e paraqitjes si dhe palën që e paraqet atë,
- Detaje të kërkesave të lidhura me Ndryshimin e Kontratës dhe me Dokumentet e Autorizimit të Ndryshimit,
- Draft Projekti që përmban ndryshimet e kërkuara,
- Detaje lidhur me fazat dhe me grafikun e zbatimit,
- Detaje të varësive të tjera (duke përfshirë cdo kontribut të kërkuar nga Pala kërkuese),
- Detaje të produkteve rezultuese për dorëzim,
- Detaje të detyrimeve shtesë individuale dhe të mjeteve për përcaktimin e tyre (për shembull, në bazë cmimi fiks ose kostoje shtesë),

- Data dhe nënshkrimi.



Neni 3

Autorizimi i Ndryshimit

Pala , që merr një Kërkesë për Ndryshim Kontrate , duhet brenda ³⁰..... ditësh duhet të kthejë përgjigje në lidhje me propozimin e bërë e cila duhet të përmbaj :

- Autorizimin ose Refuzimin e Ndryshimit të Kontratës,
- Detaje shtesë në lidhje me vendimin (nëse e kërkon),
- Propozime në lidhje me çështjet e shtruara për ndryshim,
- Data dhe nënshkrimi.

Konçesionari nuk mund të zbatoj asnjë Ndryshim të kësaj Kontrate, i përpunuar sipas këtij Aneksi, pa u miratuar dhe nënshkruar në mënyrë të rregullt nga Autoriteti.

Palët duhet te bien dakort edhe në lidhje me datën në të cilën do të hyjë në fuqi Ndryshimi i Kontratës. Në rast se palët nuk kanë parashikuar një datë të tillë, do të konsiderohet si datë e hyrjes në fuqi , data në të cilën është nënshkruar Ndryshimi i Kontratës nga të dyja palët.

Per: "BLUE EYE ONE" Sh.p.k


Administratore

Znj. Sofije MERKAJ



Për: MINISTRINË E MJEDISIT

Ndryshimi i Kontratës



Në zbatim të Aneksit 1 të Kontratës Koncesionare me nr. prot. 8618, datë 14.08.2014 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë “Blue Eye One” sh.p.k. me objekt “Marrjen me koncesion të burimit ujqor Sasaj, Bunec, në Komunën Lukovë, Sarandë”, mbi bazë të kërkesës të subjektit “Blue Eye One” sh.p.k. referuar nenit 2 të Aneksit 1, si dhe në kuadër të VKM nr. 92 datë 04.02.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 945, datë 9.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit” dhe VKM nr. 91 datë 4.2.2015 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 939, datë 9.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave”, palët:

Ministrisë së Mjedisit, e Republikës së Shqipërisë (në vazhdim referuar si “**Autoriteti**”) e përcaktuar si e tillë me **Vendim I Këshillit të Ministrave, Nr.272, datë 3 prill 2013, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënje me koncesion të burimit ujqor ‘Sasaj’, dhe miratimin e bonusit , në procedurën përzgjedëse konkurruese , që I jepet shoqërisë ‘Blue Eye One’ ”** , përfaqësuar nga Z.Lefter Koka, Ministër , Titullari I Autoritetit.

DHE

Shoqërisë ‘Blue Eye One’ sh.p.k (në vazhdim referuar si ‘**Koncesioneri**’), e regjistruar si

Vendosën dhe ranë dakort me ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 7 i kontratës do të ketë këtë përmbajtje:

"Periudha e Koncesionit

Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj (Data Efektive) dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive (Periudha Efektive). Megjithatë, në rastin e një Zgjidhjeje përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes."

Neni 2

Kopjet e hartuara

Ky Aneks kontrate hartohet në gjuhën shqipe në 4 (kater) kopje të cilat kanë të njëjtën vlerë ndërmjet tyre.

Neni 3


Hyrja në fuqi

Ndryshimi i Kontratës së koncesionit (Aneksi 6) do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të palëve në prani të një noteri publik. Në rast se palët nuk kanë parashikuar një datë të tillë, do të konsiderohet nënshkrimi si datë e hyrjes në fuqi.


Për: **MINISTRINË E MJEDISIT** Për: **MINISTRINË E BUJQËSISË** Per: **"BLUE**
ZHVILLIMIT RURAL **EYE ONE" Sh.p.k**

ADMINISTRIMIN E UJRAVE

Z. Lefter KOKA
MINISTËR



Z. Edmond PANARITI
MINISTËR



Znj. Sofije MERKAJ

Administratori
 **Blue Eye One**
Tirane - Albania